



Nr. Prot.80/1/10

VENDIM Nr. 32

**Për Miratimin e Rregullorës
për
“Regjistrimin e Përdoruesve të Telefonisë Mobile”**

Bordi i ART-së i përbër nga,

- 1) z. Ekrem Hoxha Kryetar
- 2) z. Besnik Berisha Anëtar
- 3) z. Lulzim Kurtaj Anëtar
- 4) z. Naser Shala Anëtar
- 5) z. Nijazi Ademaj Anëtar

në mbledhjen e datës 24/09/2010, konform procedurave të përcaktuara me dispozitat e ligjit bazë dhe rregulloren e brendshme të ART-së, shqyrtoi materialin e paraqitur nga Departamenti i Telekomunikacionit dhe Zyra Ligjore e ART-së mbi projekt rregulloren “**Për Regjistrimin e Përdoruesve të Telefonisë Mobile**”.

BAZA LIGJORE:

Në përputhje dhe bazuar në:

- Nenet, 4 pika 4, 69, 70, 74, 76 të Ligjit të Telekomunikacionit Nr. 2002/7, të ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-85,
- Dokumentit, Strategjia Shtetërore e Republikës së Kosovës kundër krimit të organizuar, Plani i Veprimit 2009-2012, pika 5,
- Vendimit Nr. 24 të Bordit të ART-së (Ref.Nr. Prot.57/1/10, datë: 19/07/2010),
- Neneve 20 dhe 22 të Rregullores së Brendshme të ART-së

VËREHET se:

- Drafti i projekt rregullorës “**Regjistrimin e përdoruesve të Telefonisë Mobile**” është përgatitur në përputhje me kuadrin ligjo dhe rregullator përkatës.

- Përpara paraqitjes për miratim në Bordin e ART-së, projekt rregullorja është kaluar në procedurat adekuate të këshillimit publik duke respektuar të gjitha afatet dhe procedurat ligjore, si dhe është marrë dhe mendimi i Zyrës Ligjore pranë ART-së.

ATËHERË:

Me qëllim të:

- Nxitjes së konkurrencës produktive në një mjedis të liberalizuar të telekomunikimeve,
- Krijimit të kushteve uniforme për një konkurrencë të bazuar në shërbime si dhe ofrimin e kontributit në identifikimin e keqpërdoruesve në aktivitete kriminale, dhe hartimit të kushteve të përgjithshme rregullatore, Bordi i ART-së

VENDOSI:

- I. Të miratojë Rregullorën “Regjistrimin e Përdoruesve të Telefonisë Mobile” bashkëlidhur këtij vendimi.
- II. Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga Bordi i ART-së.

Këshilla Juridike

Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk lejohet ankesa. Ky vendim u nënshtrohet çfarëdo shqyrtimi përmes procedurave administrative gjyqësore të parapara me ligjet në fuqi.

Prishtinë, 30/09/2010

Autoriteti Rregullator i Telekomunikacionit

Ekrem Hoxha
Kryetar i Bordit

Besnik Berisha	Anëtar i Bordit
Lulzim Kurtaj	Anëtar i Bordit
Naser Shala	Anëtar i Bordit
Nijazi Ademaj	Anëtar i Bordit

Aktvendimi i dërgohet:

- Operatorëve të licencuar (MNO dhe MVNO)
- Ministrisë së Punëve të Brendshme
- Ministrisë së Transportit dhe Postë Telekomunikacionit dhe
- Arkivit